




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.544/2023
Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 7, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligji Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe neni 4, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në vazhdimin e takimit 318-të, me datë 27 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Murat Hulaj propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës që të emërohet gjyqtar në shkallën e parë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.
- II. Vendimi hyn në fuqi më 27 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.288/2023, të datës 28 korrik 2023, ka shpallur konkurs të brendshëm për gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, prej të cilave dy (2) për shkallën e parë dhe një (1) pozitë për Kolegjet e Apelit si shkallë e dytë e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe Intervistim, i ka rekomanduar Këshillit, 2 (dy) kandidatë, në pozitën gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme – shkalla e parë.

KGJK, pas shqyrtimit dhe analizimit të rekomandimeve të Panelit, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligji Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe neni 4, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i propozon Presidentes së Republikës së Kosovës, emërimin e z. Murat Hulaj, gjyqtar në shkallën e parë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentes;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe Arkivit.

